



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 24

Tiranë – E hënë, 2 shtator 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 187/4, datë 26.8.2024	Për publikimin e formularit të njoftimit të konkurrimit publik “Punime mirëmbajtëse, Butrint” 3

**KËRKESË****Nr. 187/4, datë 26.8.2024****PËR PUBLIKIMIN E FORMULARIT TË
NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK
“PUNIME MIRËMBAJTËSE, BUTRINT”****SHTOJCA 1
FORMULARI I NJOFTIMIT TË
KONKURRIMIT PUBLIK**

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor – **Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint** – njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.

2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint, Parku Kombëtar i Butrintit**, Monument Kulture i Kategorisë I.

3. Llojin e punës: **“Punime mirëmbajtëse, Butrint”**.

4. Fondi limit i procedurës së konkurrimin publik: **3,392,824 lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.

5. Afati i realizimit të kontratës: **30 ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.

6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është jo më pak se **8 ditë** nga publikimi i këtij njoftimi në

Buletin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht **data 11.9.2024, ora 10:00**, në zyrën e protokollit të Zyrës së Administrimit dhe të Koordinimit, Parku Kombëtar Butrint, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.

7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimin publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimin publik në faqen zyrtare të APP-së: www.app.gov.al.

8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.

9. Hapja e ofertave nga njësia e vlerësimit do të jetë **më datë 11.9.2024, ora 11:00**, në Autoritetin Kontraktor/Zyrën së Administrimit dhe Koordinimit, Parku Kombëtar Butrint, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej **7 ditëve pune nga data e hapjes së tyre**.

10. Ofertuesit apo përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, në orën dhe në vendin e hapjes së ofertave.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2024

